

## ABSTRAKTI

Në këtë punim shkencor të studimeve post diplomike, do të trajtohet tema lidhur me administrimin ndërkombëtar të Kosovës si dhe rolin e bashkësisë ndërkombëtare në shtetndërtimin e Kosovës. Ky punim shkencor është ndërtuar në katër kapituj, përfundimet dhe literaturën. Në kapitullin e parë kryesisht flitet për historikun e administrimit ndërkombëtar në Kosovë duke përfshirë edhe veprimet e marra nga ai, po ashtu kemi hartuar si dhe kemi përmendur ndërhyrjen humanitare në Kosovë nga fuqitë ndërkombëtare. Në kapitullin e dytë flitet për Heqjen e paligjshme të autonomisë së Kosovës, fillimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, Kosova në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, mbajtja e marveshjes së Rambujesë për Kosovë, miratimi i rezolutës 1244 për Kosovë dhe vendosja e prezencës ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë.

Në kapitullin e tretë trajtohet Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë duke i përfshi insitucionet qendrore dhe lokale, Misionit ndërkombëtar në Kosovë si dhe hapat drejt procesit ndërkombëtar drejt statusit final për Kosovë. Kurse në kapitullin e katërt trajtohen temat lidhur me historinë deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës, propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, Pakoja e Ahtisarit për Kosovë dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe konstituimi i institucioneve shtetore.

Përfundimet e këtij punimi janë konstatimet kryesore mbi karakteristikat e përbashkëta të Administrimit Ndërkombëtar në kontekstin e Kosovës, i mbrojtur me akte të së drejtës ndërkombëtare dhe me aktet vendore duke filluar me Kushtetutë, ligje dhe aktet nënligjore. Në fund të këtij punimi të diplomës për studimet post diplomike në kuadër të drejtimit ndërkombëtar si drejtim i rëndësishëm i studimit, janë të paraqitura të gjitha burimet dhe regjistri i literaturës që është bërë për ndërtimin e këtij punimi pos diplomik (master).

## **ABSTRACT**

In this postgraduate studies, the topics related to the international administration of Kosovo and the role of the international community in the state-building of Kosovo will be addressed. This scientific paper is built on four chapters, conclusions and literature. The first chapter mainly discusses the history of international administration in Kosovo, including the actions taken by it, as well as we have drafted and mentioned humanitarian intervention in Kosovo by international powers. The second chapter is about the illegal abolition of Kosovo's autonomy, the beginning of the armed uprising in Kosovo, Kosovo in the international spotlight, the maintenance of the Rambouje agreement for Kosovo, the adoption of Resolution 1244 on Kosovo and the establishment of the international civil and security presence in Kosovo.

The conclusions of this paper are the main findings on the common characteristics of international administration in the Kosovo contest, protected by acts of international law and local acts starting with constitutions, laws and bylaws. At the end of this postgraduate degree in the international direction as an important study direction, all the sources and the literature register that have been made for the construction of this paper but master's are presented.